



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË



Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Datë 30.06.2026

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

Datë 30.06.2026

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) KORSEL SHPK - J64104124G, pjesëmarrja në BOE 56%, Adresa: Korçë, Lagj.17, Rruga Midhi Kostani, objekti Nr.23 dhe FUSHA shpk - J61922018S, pjesëmarrja në BOE 44%, Adresa: Rruga “Murat Toptani”, Zona Kadastrale 8150, Tiranë, 1001

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO ☒

Tipi i kontrates: **Shërbime**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur** (mbi kufirin e lartë monetar)

Numri i procedurës: **REF-86091-05-19-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti: **“Shërbimi i pastrimit”**

Fondi limit: **382,442,137 (treqind e tetëdhjetë e dy milion e katërqind e dyzet e dy mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) lekë, pa tvsh.**

Afati: **36 muaj duke filluar nga data e lidhjes te kontrates.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **20.05.2026**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Datë 25.05.2026, Nr.33**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

**oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatoreve - Shoqëria KORSEL SHPK, NIPT J64104124G dhe Shoqëria FUSHA shpk NIPT J61922018S me vlerën:  
380.562.120 (treqind e tetëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëzet) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. Shoqëria ALKO IMPEX CONSTRUCTION shpk, NIPT K91628013D me vlerën:  
382.311.017,70 (treqind e tetëdhjetë e dy milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëmbëdhjetë, presje shtatëdhjetë ) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqëria ALKO IMPEX CONSTRUCTION shpk, NIPT K91628013D, për arsye:

Operatori ekonomik s'kualifikohet pasi nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 2.3.7, të dokumenteve të tenderit, sipas të cilit: "Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi apo me qira një ambient me sipërfaqe jo më pak se 800 m<sup>2</sup>, i cili do të shërbejë për parkimin e mjeteve jashtë orëve të shërbimit, depozitimin dhe riparimin e kontenierëve të dëmtuar, si dhe për depozitimin e materialeve që i nevojiten për realizimin e plotë të shërbimit të pastrimit. Për vërtetimin e ambientit në pronësi duhet të paraqitet Çertifikata e Pronësisë dhe, në rast se ambienti është me qira, duhet të paraqitet kontrata e qirasë noteriale e shoqëruar me Çertifikatën e Pronësisë. Kontrata e qirasë duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi." Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në ofertë rezulton se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar asnjë dokument për të provuar disponimin e ambientit të kërkuar, qoftë në pronësi apo me qira, si dhe nuk ka paraqitur Çertifikatën e Pronësisë apo kontratën noteriale të qirasë, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk ka arritur të provojë përmbushjen e kriterit 2.3.7, dhe KVO bazuar në nenin 92, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024, si dhe në nenin 82, pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, skualifikon operatorin ekonomik

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ofertuesin KORSEL shpk, NIPT J64104124G, si udhëheqës i bashkimit të operatorëve Korsel shpk dhe Fusha shpk, Adresa: Korçë, Lagj.17, Rruga Midhi Kostani, objekti Nr.23, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 380.562.120 (treqind e tetëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëzet) lekë pa tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**SOTIRAQ FILO**